



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE**



**PROGRAMI I LËNDËS
GJUHË E SHKRUAR FRËNGE 1**

Ngarkesa: 4 ECTS, 40 orë seminare

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti I, semestri I

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme lëndore: Ky modul me karakter praktik do t'i japë studentit të vitit të parë mundësinë të përvetësojë dhe përmirësojë kompetencat gjuhësore dhe leksikore, kompetencat e të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim nëpërmjet analizave leksikore, gramatikore dhe kulturore. Do të favorizohet reflektimi i studentit në praktikat gjuhësore me shkrim me një qasje pedagogjike që bazohet në vëzhgimin, analizën, ndërveprimin dhe pavarësinë e studentit në lidhje me aspektet gjuhësore dhe drejtshkrimore. Paralelisht me përvetësimin e kompetencave për të përpunuar materiale të shkruara, për të komunikuar me shkrim do të punohet edhe për zhvillimin e kompetencës kulturore e ndërkulturore të studentëve, nëpërmjet studimit të dokumenteve autentike dhe aktiviteteve që nxisin reflektimin dhe hapjen ndaj kulturës së tjetrit.

Objektiva specifike lëndore:

- Të thellojë dhe të përmirësojë njohuri thelbësore të strukturave gjuhësore të gjuhës frënge në planin leksikor, sintaksor dhe gramatikor;
- Të zhvillojë aftësitë e vëzhgimit dhe analizës, si dhe shumë strategji të të nxënimit që do të çojnë në mënyrë progresive drejt autonomisë gjuhësore;
- Të zhvillojë aftësitë për të shprehur me shkrim duke zgjedhur dhe përdorur shprehjet dhe strukturat e duhura bazë për të argumentuar, shpjeguar dhe arsyetuar opinionet dhe dëshirat.

Rezultate të pritshme:

- Të forcojë dhe përmirësojë njohjen e strukturave thelbësore të gjuhës në mënyrë që të thellojë njohuritë bazë gramatikore, semantike dhe ortografike.
- të kuptojë një tekst të shkruar
- të hartojë një plan për t'u shprehur me shkrim
- të pasurojë fjalorin dhe të komunikojë me shkrim
- të analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi burimet e ndryshme dhe literaturën e shfrytëzuar